



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

ZYRA E KRYETARIT

Nr. 04-400-11295 dt. 27.02 2019

Në vështrim të nenit 58 dhe 68 paragrafi 68.3 të Ligjit nr.03/L-040, nenit 12 dhe 22 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.12-320-19338 të datës 07.04.2017 dhe nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit të Komunës bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Ftohen organizatat joqeveritare të sektorit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit që janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetet e tyre në Komunën e Drenasit, se mund të aplikojnë me projektet e tyre për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Drenasit për vitin 2019.

Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve përfshijnë:

1. Projekt propozimi (i vulosur dhe nënshkruar nga aplikuesi);
2. Aplikacioni;
3. Dokumenti identifikues;
4. Certifikate e vendbanimit (për persona fizik);
5. Certifikata e regjistrimit (për persona juridik);
6. Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
7. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (për persona fizik);
8. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
9. Konfirmimin aktual nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

Subvencionet për Kulturë, Rini dhe Sport

Komuna do të ndajë subvencione për Kulturë, Rini dhe Sport duke përfshirë:

1. Klubet sportive (pagesa e regjistrimit të klubeve në Federatat përkatëse, e kuotizimit, referimit, transportit dhe të ushqimit për ndeshjet zyrtare)
2. Sportistët e dalluar
3. Garat sportive
4. Shoqëritë amatore (ansamblet)
5. Teatrot amatore

R. H.

6. Festivalet
7. Botimi i librave/shkrimeve letrare
8. Ekspozitat me fotografi
9. Aktivitete me karaktere garuese
10. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune
11. Promovim i librave
12. Promovim i talentëve të rinj

Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport

- Sofra poetike “Ymer Elshani” 2019, prill 2019
- Programi Artistik për 14 Qershor Ditën e Çlirimit të Drenasit, qershor 2019
- Programi artistik për manifestimin Ditët e Mërgatës, gusht 2019
- Muaji i Rinisë, shtator 2019
- Manifestimi Ditët e Humorit Drenasi 2019, tetor 2019
- Program Artistik për Festën e 28 nëntorit, ditën e Flamurit, nëntor 2019
- Revista e Folklorit Burimor Shqiptar “Drenasi 2019”
- Program festiv për Natën e Vitit të ri, dhjetor 2019

Gjatë ndarjes së subvencioneve, në kushte të barabarta, Komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:


Projektet që kanë siguruar bashkëfinancim nga palët e treta sipas vlerës;

Projektet të cilat mund të gjenerojnë të hyra financiare për kërkuesin e subvencionit, në funksion të sigurimit të qëndrueshmërisë së projektit për periudhën e ardhshme;

Tërheqja e aplikacioneve mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Zyrën Pritëse nr.10, 11 12 dhe dorëzohen në të njëjtën zyre.

Aplikacionet e pakompletuara të paprecizuara, të panënshkruara nuk do të shqyrtohen.

Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e shpalljes në webfaqen e Komunës dhe në mediat lokale.


Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Drenas, 27 shkurt 2019